



02Nr 9771 /2022
29.11.2022

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, Kapitulli V neni 67 dhe 68 , Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 neni 5 pika c, Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8 Udhëzimin Administrativ(MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.05/2021, Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm , Komuna Hani i Elezit shpallë:

KONKURS
(Për plotësimin e vendit të lirë të punës)

Institucioni: **Komuna Hani Elezit**
Drejtoria: **Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport**

1. Titulli I vendit të punës: **Mësimdhënës/e i Arsimit Fillor
njësia/ sektori: SHFMU “Kështjella e Diturisë”-fshati Paldenicë**

Numri I pozitave: **Një (1) pozitë me afat të pacaktuar**
Koeficienti/Grada: **A-421/1**
Orët e punës: **40 orë në javë**

Detyrat dhe përgjegjësitë për Mesimdhënës/e :

- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin e punës , në harmoni me legjislacionin në fuqi, që të rregullojë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;
- Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mesimdhënies;
- Të përgadit me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mesimdhënies dhe vlersimit në përputhje me me Udhëzimet Kurikulare;
- Të mbajë ditarin personal të vlersimit të nxënësve.
- Të marrë pjese aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës;
- Të respektoj autoritetin e drejtpërdrejt të zyrtarit , të cilit i raporton dhe ti kryej detyrat që mund ti caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim:

- Fakulteti i Edukimit-programi fillor
- Fakulteti i Mësuesisë;

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
- Rezymeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje).
- Diploma e kualifikimit (ose certifikata) duhet të jete kopje të noterizuara.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (nga gjykata)
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Afati dhe mënyra e aplikimit:**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 29.12.2022 deri 12.01.2023 (16:00).**

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati I parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net>

Dokumentacioni I kandidatëve të cilët nuk I plotësojnë kriterete konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në

faza tjera do të ftohen vetëm kandidatët që I plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura

(nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin

Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të

aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Mirë priten aplikacionet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>, në web faqen e komunës

<https://kk.rks-gov.net/haniiielezit> dhe në tabelën e shpalljes.



Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi

(Handwritten signature)